

H Y L L I I D R I T Ë S

E PËRKOHSHME KULTURORE - LETRARE

EDITORIAL

Vlera e mendimit vetjak 3

GJUHËSI

Bardhyl DEMIRAJ

Grimca biografike për autorët tanë të vjetër 6
V. Ndue Babi (1659 – 1728)
VI. Gjergj Engjëll Radovani (1733-1790)
VII. Vincenzo Basile SJ (1811-1882)

Evalda PACI

Kuvendi i Arbënit (1703), një kapërcyell i rëndësishëm 50
në historinë e shkrimit shqip

STUDIME LETRARE

Martin CAMAJ

Aktualizimi i poezisë fishtjane 60

Alfred ÇAPALIKU

Afri e dallime mes Camajt e Ungarettit 65

Lisandri KOLA

Mbreti i Tules nga Ndré Mjedja 69
(paradigma karduçiane e përkthimit)

Tringë DUKAGJINI

Simfoni 78

STUDIME HISTORIKO-LETRARE

Ledri KURTI

At Zef Valentini dhe Shqipëria brenda tij 87

ARKEOLOGJI

Gëzim HOXHA

Kisha e "Shën Mëria e të Ngjitunit në Qiell" e Kaçës dhe Naraçit 96

HISTORI

Lucia NADIN

Venezia, anno 1503: concessione di Arche di Sepoltura alla Scuola degli Albanesi nel primo Chostro del Convento dei Frari. Il dato in un complesso scenario 111

Edmond MALAJ

Dëja në Mesjetë 122

Paulin MARKU

Ndihma e Italisë në ngritjen e ekonomisë shqiptare gjatë viteve (1925-1932) 149

BRILANTE BIBLIKE

Át Daniel GJEÇAJ, OFM

Libri i Fjalëve të Urta (Proverbave) 164

BOTIME TË REJA - REÇENSIONE

Anila OMARI

"Doktrina e kërshen" e Gjon Kazazit dhe botimi kritik i saj (Shënime mbi librin e Bardhyl Demirajt "Gjon P. Nikollë Kazazi dhe "Doktrina" e tij, ASHAK, Prishtinë, 2006) 190

NEKROLOGJI

Willy Gjon Kamsi (1926-2017) 198

ARKIVI I HYLLIT

Át Anton HARAPI, OFM

Letër-qarkore drejtue famullitarëve të Provincës Françeskane Shqiptare 200

Át Donat Kurti, OFM

Nji permbledhje e shkurtë rregullash njerziet 213

BARDHYL DEMIRAJ

Grimca biografike për autorët tanë të vjetër**V. Ndue Babi (1659 – 1728)****1. Dy fjalë hyrëse**

Me ndërmarrë në kohën tonë një studim me karakter të mirëfilltë njohës-enciklopedik mbi personalitetin e Imz. Ndue Babit (= it. <Mons. Antonio Babbì>) shkasit mund të jenë të ndryshme. Ndër to më i thjeshti, pra më bindësi gjan të jetë në pamje të parë të qenit të tij për 25 vjet me radhë ipeshkëv i Dioqezës së Shkodrës, çka vjen me thënë që mungesa e tij në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar, sidomos në botimin e tij të dytë, por aspak fatlum në plot tri vëllime (Tiranë 2008/9) është thujse e vetëkuptueshme, paçka se një klerik shqiptar me atë pozicion në kapërcyell të shek. XVII – XVIII përfaqësonte si i tillë elitën e kulturës e të inteligjencës vendore edhe për atë bashkësi etnike, që përdorte shqipen si mjet komunikimi, anipse e kufizuar kjo qoftë edhe vetëm për atë shtresë sociale (të besimit katolik) që ishte mësuar të ngjëronte të paktën predikimin shqip, kur shkonte në kishë “me pā meshë”. Gjithsesi tundimin tonë e nxit shumë më shumë një shkas i dytë, ai i madhi: bash kur mësojmë se – dale-dale!!! – ky klerik na paska lënë trashëgim në letër të zvjerdhur nga motet një tekst të vjetër shqip që i takon fillimit të shek. XVIII. Ndue Babi na ka lënë në fakt më shumë se një tekst shqip, por vetëm njëri, ai zindjellësi (!), mundi të mbijetonte, pikërisht *Mallkimet* – ashtu siç dinte t’i lëshonte vetëm ai – *t’Ejten e Madhe* (1704), madje të kopjuara këto dyherësh dhjetëvjeçarë më pas nga të tjera duar, prashtu që të lëshoheshin rishtas “me zâ të nçelë” buzë altarit nga të tjerë ipeshkvij.¹

Asgjëmangut mëtuam radhazi disa ndër arsytet që na yshtën të merreshim konkretisht me këtë klerik e njëherësh lëvrues në historinë e kulturës së shkrimit shqip, duke përcjellë kështu në letër vullnetin dhe dëshirën e mirë me nxitur kërkime të mëtejshme të natyrës njohëse-enciklopedike qoftë për personin në fjalë ashtu edhe për shumë e shumë bartës, lëvrues dhe studiues të kulturës shqiptare në shekuj, të cilët rrezikojnë të fshihen përfundimisht prej kujtesës historike-intelektuale shqiptare në kohën tonë.

¹ Shih më hollësisht Demiraj 2014.

Në studimin tonë modest jemi përqendruar kryesisht në do të dhëna të shpërndara aty-këtu në manualët enciklopedikë ekleziastikë të kohës (Farlati & Coleti, bl. VII 1817; Eubel, bl. VI 1958), sikurse edhe në disa letra e relacione, të botuara ndërkohë në shumësinë e tyre, ose që ndodhen ende të depozituara në Arkivin Qendror të Shtetit të Republikës së Shqipërisë (AQSH). Duam pra t'i rrëfëhemi qysh në fillim lexuesit tonë sqimatar, se studimi ynë nuk mëton assesi një ndërmarrje ballore dhe shteruese ndaj personalitetit në fjalë, të cilin shumëkush do të mund ta njihte në detaj vetëm pas një krehjeje fatlume të dokumentacionit përkatës në dosjet e shumta të Arkivit Historik të Propaganda Fide-s (Romë). Sa i përket klasifikimit dhe sistematizimit të materialit që kemi mundur të sigurojmë, jemi përqendruar në katër rubrika: a) të dhëna të shkurtra biografike mbi Ndue Babin; b) rinia dhe formimi i tij meshtarak-intelektual; c) karriera klerikale dhe aktiviteti i tij baritor; e së fundi d) vendi i tij në kulturën e shkrimit shqip.

2. Të dhëna të shkurtra biografike

Ndue Babi do të ketë lindur aty rreth vitit 1659 në katundin /Naraç/ që i takonte atëbotë Dioqezës së Sapës. Ndërsa për vendlindjen e tij lejohemi të citojmë literaturë enciklopedike të mirënjohur për vjeljen e akribtë të burimeve dokumentare-administrative të Vatikanit (Eubel VI 1958 317), për vitlindjen na duhet të bëjmë kalkulimet e rastit, duke mbajtur parasysh moshën 43-vjeçare, të kumtuar pas gjase po prej tij gjatë asaj vizite të gjatë apostolike që zhvilloi në fund të vitit 1702 në çdo dioqezë e famulli të Provincës Kishtare të Arbënit e të Arqipeshkëvisë së Shkupit arqipeshkvi i dikurshëm i Tivarit Vincenz Zmajević-i, pra edhe në misionin e Hajmelit (= <Haimelli> – shih më poshtë), ku vepronte atëbotë edhe Ndue Babi si misionar apostolik (Bartl 1979 62v.).

Siç na mësojnë Farlati & Coleti: “[Babi] vdiq në moshë të shtyrë dhe u varros në Kishën e Shën Shirgjit”² rreth muajit tetor të vitit 1728,³ pra aty te 69 vjeç, një moshë kjo e konsiderueshme për kohën kur jetoi, paçka se jeta dhe punët nuk duhet t'i kenë ecur e rrjedhur gjithherë në vaj (shih § 4.3).

3. Rinia dhe formimi meshtarak-intelektual

Në vitin 1676 Babin e ndeshim në Kolegjin Pontifikal të Shën Pjetrit dhe Shën Palit në Fermo (= <Collegio Pontificio di San Pietro e Paolo

² „[...] & edmodum senex vita decedens in templo Sergiano sepulturae traditus fuit.” (shih § 4.3)

³ Eubel: *loc. cit.*

di Fermo>: 1663-1746),⁴ si njëri ndër kolegjet që administronte atëbotë Kongregacioni i Shenjtë i Propaganda Fide-s. Ky kolegji njihet më fort në historinë ekleziastike dhe kulturore të Ballkanit perëndimor si Kolegji Ilirik i Fermos, i ripagëzuar kështu falë destinacionit zanafillës si një institucion arsimor-fetar për formimin teologjik-intelektual të rishtarëve që vinin kryesisht nga provincat e Ilirisë, një emërtim ky kulturor-geografik diturak, me të cilin identifikoheshin atëkohë zonat perëndimore të Ballkanit. (Demiraj 2015 425vv.)

Ndoi ynë rezulton të jetë regjistruar në kolegji më 20 korrik të atij viti, duke studiuar po aty shtatë vjet me radhë, deri më 10 tetor 1683 (Bartocetti 1935 162), kur përfundon formimin meshtarak dhe merr izmën për t'u kthyer me mision apostolik në atdhe, domethënë në Dioqezën e Sapës, ku do të përmbushte ato detyrime e nevoja baritore që i caktonte ipeshkvi për të mbarështuar grigjën e vet. Se si e kaloi periudhën 7-vjeçare të qëndrimit në kolegji, si eci me studimet, çfarë rezultatesh pati dhe a e përjetoi shugurimin priftëror menjëherë pas sosh, janë këto pyetje pas pyetjesh, të cilave edhe në mungesë informacioni burimor lejohemi t'u japim deri diku përgjigje pozitive, vetëm po të mbajmë parasysh karrierën e tij klerikale për plot 25 vjet si ipeshkëv i Dioqezës aspak të vogël të Shkodrës, si edhe ato vlerësime të njohura të njërit apo tjetrit relator për Kongregacionin e Shenjtë të Propagandës.

4. Karriera kishtare dhe aktiviteti baritor

4.1. Famullitar në Hajmeli të Dioqezës së Sapës (? – 1702)

Babi filloi angazhimin e tij misionar apostolik pas gjase në dioqezën amë, ku qëndroi deri në fund të vitit 1702, ase më saktë e zyrtarisht deri më 15 janar të vitit 1703, kur iu dorëzua pallium-i i ipeshkvit të Shkodrës, anipse ishte dekretuar dhe aprovuar ky post më shumë se një vit më parë, në datat 19 dhe 21 korrik 1701 (Eubel *loc. cit.*), ndërsa më 25 dhjetor 1702 ishte Papë Klementi XI që firmosi dhe vulosi brevën e emërimit të tij (Farlati & Coleti *loc. cit.*). Siç cekëm shkurt më lart, në fund të aktivitetit të tij baritor në Dioqezën e Sapës e ndeshim në famullinë e Hajmelit, ku vepronin tre meshtarë, të cilët mbarështonin tre fshatra: Hajmeli me 55 shtëpi katolike, përkatësisht 368 frymë, <Caccia> me 21 shtëpi katolike, përkatësisht 157 frymë dhe <Renesa> me 23, përkatësisht 134 sosh. Këto të dhëna i nxjerrim prej relacionit të zgjeruar të Vincenz Zmajević-it (1702; Bartl 1979 62v.), i cili e përshkruan këtë famulli, si vijon:

“Villa distante trè miglia da Mietia [= *Mjeda*] in pendenza

⁴ Për hollësi të mëtejshme të formimit teologjik-intelektual të rishtarëve shqiptarë në këtë kolegji shih Demiraj 2015.

d'amenha collina alle radici del monte, è piena di vigne, nelle quali gli abitanti fanno singolar profess[i]one, e col uender uino, ritraggono molto uantaggio. Hà la Parochiale col titolo di. S. Maria, Chiesa la più grande di questa Diocesi, et in buon stato coll'antiporto, e cimiterio longo, quanto la Chiesa tutto coperto. Hà beni stabili in buona quantità cioè 72 zappe di vigna, 16 campi seminarij, lasciati da diuersi benefattori con obbligo di 35 Messe annue, et in oltre un oliueto. L'entrate sono godute da Parochi, li quali hanno di più il beneficio fisso di 207 Messe, oltre le solite di grano in ragione d'una quarta di formento per ogn'anima, che si comunica, e buona quantità di uino. [...] Vi è anche una Chiesa dedicata à S. Paolo di grandezza mediocre in buon ordine materiale, ma priua delli paramenti Sacri, seruendosi in occasione delle Messe di quelli della Parochiale."

Interes edhe më të madh për rastin tonë fiton vlerësimi që i bën Zmajević-i famullitarit Ndue Babit – i zgjedhur tashmë si ipeshkëv i Shkodrës – sikurse edhe aftësive të tija të lëvdueshme meshtarake. Kështu shkruan ai ndër të tjera:

"Esercitano la Cura D. Antonio Babbi [= Ndue Babi] eletto Vescovo di Scuttari, D. Marco Zeza [= Mark Zeza], e D. Paolo Cabasci [= Pal Kabashi]. | Il primo d'anni 43 esemplare, prudente, tenuto in stima da tutta la Diocesi. Solo trà tutti li altri Parochi hà amministrato puntualm[en]te la Cura, predicando tutti li giorni festiui di concorso, e istruendo il Popolo nelli rudimenti della fede; essendo perciò di questa Parochia il miglior ordine dell'altre, benche non scriuono li Battesimi, li Matrimonij, li nomi delli defonti, non si faccino denunzia matrimoniali, ne si preuenga il matrim[onio] colla confessione Sacramentale, giusta la corruttela universale della Diocesi. [...]"

4.2. Pjesëmarrës aktiv në Kuvendin e Arbënit (Mërqinjë, janar 1703)

Babi pjesëmerr si anëtar aktiv me votë vendimmarrëse në Kuvendin e parë Provincial të Arbënit, që është një pikë kulmore në historinë ekleziastike-kulturore të trevave shqipfolëse në fillim të shek. XVIII. Andaj nuk është assesi rastësi që emrin e tij e ndeshim edhe si firmëtar i vendimeve të atij kuvendi në botimin e akteve origjinale latinisht (Romë 1706 95), khs.:⁵

⁵ Shih emrin e Ndue Babit, i gjashti nga sipër: "Unë Ndue Babi, ipeshkëv i zgjedhur i Shkodrës

Nos Vincentius Zmajevich Archiepiscopus Antiba-
rensis Servica Primas, Viscator Apostolicus Alba-
nia defunctus subscripsimus.
Ego Petrus Zumi Archiepiscopus Dyrachiensis assen-
tiens subscribo.
Ego Petrus Caragich Archiepiscopus electus Scupo-
rum assentiens subscribo.
Ego Georgius Episcopus Sapparensis assentiens sub-
scribo.
Ego Nicolaus Uladagni Episcopus Alexiensis assen-
tiens subscribo.
Ego Antonius Babbì electus Episcopus Scodrensis af-
sentiens subscribo.
Ego Marinus Gini electus Episcopus Pullatensis af-
sentiens subscribo.
Fr. Agidius de Armento Praefectus Apostolicus Mis-
sionum Albania meo, & PP. Missionariorum no-
mine assentior.
Ego Fr. Franciscus Maria à Lycio Praefectus Aposto-
licus Missionum Macedonia meo, & Missionario-
rum nomine assentior.
Ego Fr. Marrinus à Gionima Minister Provincialis
meo, & Patrum de Observantia nomine assentior.

Fr. Raymundus Gallani à Secretis.

Faksimile 1: Pjesëmarrësit vendimmarrës në Kuvendin e Parë të Arbënit (CA Romae 1706 95)

Prania e tij aktive në këtë kuvend dha pas gjase edhe frytet e rastit në zgjidhjen e një numri problemesh me karakter administrativ-kishtar që shkaktonin prej kohësh mosmarrëveshje ndërmjet Dioqezave kufitare të Shkodrës, Lezhës, Sapës dhe Pultit. Të tilla janë edhe vendimet e marra e të pasqyruara si të tilla në Kreun VI të Pjesës së Tretë të akteve, të cilat po ia përcjellim lexuesit si ilustrim prej botimit tonë kritik (Demiraj 2012):

KREU I GJASHTI

Te dheut se Posteripese

[f. 79] Nder kundershime e nder davija qi jane nde keta kohe me merzite t' upeshkupinjevet, thomi se rā nde te keq dheu i Posteripese, i silli u bā bairaktāri i travajavet. Tre upeshkupinje mbashk thone se dheu i Posteripese asht i tyne. Upeshkupi i Shkodrese thot, asht emi. Upeshkupi i Zadrimese thot, asht emi. Upeshkupi i Pullatit thot ende, asht emi. E ndierse keta merren nder vete, te mierete te kershtene te Posteripese jesene si puna harruem, pā te shende vizitime, pā çobante e

nëshkruaj [si] i pranishëm.”

pā ugiçi, sikūr grigja dām n' shoqash perrikullohet. Keta te pāfat mbe nj' ane i rref te perzanite e te pāmisheriere, mbe tietere nevoja. Travajat s' i lane gjalle, vobezija po i nderremon zaman. Kinese te zeza mos t' ashtervinjene mā keq, duhet me pritune dermanin prei Kunvendit Shind se Propagandese. Ndiere s' vien fiala andei, mos te perterihet gjā, posi jane tashti kafshat, ashtu te çendronjene, ndiere te kputet davija. Po mos te pesmatohet çarta e kesai pune, urdhenonjeme qi ta mbane keshtu:

Katundesh te Meshkallese, Mezerekut, Shporit, [f. 80] Shllakut e te Gustese prei parokut se Vierdhet, dioçeze se Zatrimese te sherbehen, sikūr ndieri tashti ja- ne kiene sherbyem.

Paroku i Jubanit qi kā sherbyem Sheldijese, Gavoshit e Ganjollese t'i sherbenj ende keshtu tutie si i paskā sherbyem, parandai ndonese asht paroku i Dioçeze se Shkodrese.

Po ato tri mahalla: Harre, Kurthe e Villulleze qi tashti jane ndene sundi te patrevet misionareve te Toplanese, Dioçeze se Pullatit, jesene ende ndene sundi te fratinet qi i sherbenjene si prifti i famullise.


Keshtu prā gjithisilli paroqani te jete e çendronj mbe kunfī e mb' esapi te paroqese qi kā sherbyem me ligje. Jet suspenduem ai qi guxon me u perxiem e me hīm nde bashtine te tietarit pā vollundete e testūri te Selliese Shind e te Kunvendit Shind te Propagandese ndene sundit e pushtetese, kuina ende me faqe perdhē pervemi keto Dekreta tona." (KA: bot. I shqip, Romë 1706 79-80)

4.3. Ipeshkëv i Dioqezës së Shkodrës (1703 – 1728)

Siç e cekëm edhe më lart ishte Papë Klementi XI – i njohur në letërsinë ekleziastike-historike shqipe edhe si Papë Shqiptari – ai që firmosi e vulosi përfundimisht breven e emërimit të Babit si ipeshkëv i Dioqezës Shkodrës më 25 dhjetor 1702. Babi zuri me këtë rast vendin e mbetur vakant prej vrasjes së Ndue Negrit (= <Antonio Negri>), i martirizuar prej pushtetit vendor osman në qershor të vitit 1698 (Eubel *loc. cit.*). Për këtë kumtojnë edhe Farlati & Coleti (*loc. cit.*), të cilët përpos rrethanave të zhvillimit të Kuvendit të Arbënit dhe zgjidhjes së një numri çështjesh në të mirë të Dioqezës së Shkodrës, përshkruajnë edhe rolin e Ndue Babit, pasi hipi në fronin e ipeshkëvit, duke u angazhuar me vetëmohim për të zbatuar e vënë në jetë vendimet e Kuvendit të Arbënit. E për këtë sigurisht që do t'i duhej të përballej edhe me ndeshtrashat e kohës, vendit dhe rastit për plot 25 vjet me radhë, derisa ndërroi jetë, khs.:

ANTONIUS IV. EPISCOPUS SCODRENSIS XXXIX. | Presbyter Sappatensis ex familia Babbis, quem Clemens XI, in Sedem Scodrensem Antonio Nigro suffecit; 25. Decemr: 1702; providit Ecclesiae Scutarensi vacanti per obitum Antonii Negri de persona Antonii Rabbi [sic. – B.D.] Presbyteri Sappatensis. [...] Post initam sui Episcopatus possessionem in id potissimum incubuit, ut Concilii decreta per dicecesim stabilita integre ab omnibus servarentur. Plures in suo munere peragendo curas ac molestias perpessus est, quas forti animo ad extremum spiritum depluit, vicitque; & admodum senex vita decedent in templo Sergiano sepulturae traditus fuit.“ (Illyricum Sacrum VII 1817 332vv.)

Parë nga kjo perspektivë ne jemi tash në gjendje të mirëkuptojmë me respektin përkatës organizimin e Sinodit Dioqezan të Shkodrës që ndërmorri Babi një vit më vonë (31.03.1704 në Beltojë të Shkodrës). Vendimet e këtij sinodi – falë rëndësisë së vet – i ndeshim të regjistruara dhe të plotësuara edhe katër dekada më vonë në bleun e dytë të Regjistrit të Ipeshkvisë së Shkodrës (1744-) e që kanë pas gjase për autor pasuesin e tij në selinë ipeshkvore, Imz. Pal Pema Kampsin dora vetë.⁶



Faksimile 2: Faqe e parë e akteve të kopjuara të vendimeve të Sinodit Dioqezan të Shkodrës (AQSH: F.132/a, V.1744, D.1, f. 17)

⁶ Ky regjistër është i depozituar në AQSH me signaturën: F.132/a, V.1744, D.1, f. 17-29. Shih më hollësisht edhe Demiraj 2014 141vv.

5. Vepra dhe roli i Ndue Babit në kulturën e shkrimit shqip

Nga e njëjta dorë buron pas gjase edhe teksti i kopjuar shqip (dhe italisht) i *Mallkimeve qi leshon ipeshkvi t'Ejnten e Madhe* (=it. *I Scommunicati nel Giovedi Santo*), tekst ky që i paraprin në regjistrin në fjalë atij të vendimeve të Sinodit Dioqezan të Shkodrës. Ky tekst shqip dëshmon ndër të tjera vijimësi në traditën shkrimore si edhe në funksionet e reja që mëtonte me kohë dhe ndërkohë shqipja e shkruar në marrëdhëniet e klerit vendor me grigjën e vet, bash me bashkësinë shqipfolëse të besimit katolik të paktën në Dioqezën e Shkodrës.

Shtojmë gjithashtu që këtë tekst shqip, që ruhet në AQSH në dy variante, ia kemi nënshtruar dikur një analize të mirëfilltë gjuhësore-filologjike (Demiraj 2014), duke mundur të saktësojmë bindshëm edhe vendin e tij në kulturën e shkrimit shqip në arealin kulturor të Veriut (katolik) shqiptar, i cili për periudhën në fjalë (gjysma e parë e shek. XVIII) dëshmon qartas një bashkëjetesë tri traditash shkrimi me alfabet (kryesisht) latin,⁷ të cilat vijnë në një mënyrë a një tjetër risitë e përfutur në kodin alfabetik nga shkrimtarët e mëhershëm shqiptarë si Budi dhe Bogdani në shek. XVII, ose të zhvilluara më tej nga Kazazi në mes të shek. XVIII. Ndër këto tri nënsisteme kodi i përdorur prej Kazazit – më përhapje ndoshta vetëm në pjesën verilindore të këtij areali – përbën risinë e kohës në kulturën e shkrimit shqip. Tradita e zhvilluar nga Budi kishte gjetur ndërkohë strehë ndër etërit françeskanë (të paktën) në dioqezën e Pultit.⁸ Ndërsa varianti i përdorur prej Ndue Babit pasqyron qartë vijimësi të (pa)ndërmjetshme të kodit alfabetik që risoi dhe përdori Pjetër Bogdani (1685), si ipeshkëv i dikurshëm i Shkodrës.⁹ Përkthyer ndryshe, Babi i përshtatet në shkrimet e veta në gjuhën shqipe shi traditës i shkodrane në kulturën e shkrimit shqip, të përditësuar dhe sendërtuar prej “mâ të vlerit ndër shkrimtarët e hershëm të shqipes.” (Rrota 1941 46)

Përdorëm më lart jo pavëmendshëm numrin shumë lidhur me “shkrimet e veta në gjuhën shqipe” të Ndue Babit. Edhe pse prej tij njohim deri sot vetëm një tekst të shkurtër shqip, madje edhe atë falë rastësisë fatlume ase fatmirësisë së rastit, sepse Babi ka shkruar pa dyshim shumë më shumë se vetëm një syresh. E kjo ka të bëjë më fort si gjithëherë me rastësitë fatkeqe ase fatkeqësitë e rastit në kulturën e shkrimit shqip, pasi të gjitha rropatjet e tij që këto shkrime të shihnin dikur dritën e ditës në shtypshkronjën e Propaganda Fide-s në Romë ishin të destinuara të dështonin. Këtë kumt të trishtë e mëson i pari

⁷ Shih P. Bartl – B. Demiraj: Letra e fretërve të Pultit (1761) dhe vendi i saj në kulturën e shkrimit shqip në mes të shek. 18-të, në: “Hylli i Dritës” 4 [2008] 39vv.

⁸ Shih më hollësisht Bartl & Demiraj 2008.

⁹ Demiraj 2014 162.

kolegu dhe miku ynë Gurga Gurga (2009 35), i cili pati mirësinë të na verë më pas në dispozicion edhe kopjen e një teksti protokollar të komisionit vendimmarrës në instancën e lartë të Kongregacionit të Shenjtë të Propaganda Fide-s, ku thuhet shprehimisht se si Ndue Babi kishte bërë kërkesë të përsëritur për shtypin e një doktrine të krishterë si edhe të litanive të Virgjëreshës Hirplotë, përkthyer shqip prej tij nga latinishtja, por drejtuesi i këtij institucioni, kardinali Barberini nuk e dha pëlqimin për botim, khs.:

“Mons. Babbi Vescovo di Scuttari con memoriale presentato dal suo Agente, torna di nuovo a supplicare l’EE. VV. | Primo, di un luogo in qualche collegio [...] | secondo della Stampa della Dottrina Christiana, e letanie della Beata Vergine, da esso tradotte dal Latino in Lingua Albanese per beneficio di quei Popoli. | Di che il medesimo Or[ator]e ha altre volte fatto istanza nel 1715, e fù rimessa all’ Emmo Barberini ma per quanto asserisce lo stampatore l’opera non fù stimata a proposito per esser stampata. [...] Ad 2^{us} = Arbitrio Emmi Barberini.” (ASPF Acta Sacrae Congregationis 1717 vol 87 ff. 279v. [mbledhja e dt.] 23 Augusti 1715)

6. Përfundim

Mbyllim këtu studimin tonë me dëshirën dhe shpresën e mirë të kemi ravijëzuar sado përciptas konturet e një portreti të ri në historinë e kulturës shqiptare e si të tillë edhe në atë të shkrimit shqip. Jemi gjithsesi më se të vetëdijshëm se ky portret do gëzojë plotësinë e duhur, vetëm pasi të jenë bërë objekt i analizës së mirëfilltë shkencore qoftë ajo trashëgimi e tij në dorëshkrim, e cila ruhet dhe njihet sot si e tillë, siç janë p.sh. në AQSH aktet e vendimeve të Sinodit Dioqezan të Shkodrës (1704), ashtu edhe ajo trashëgimi që ruhet, por ende s’ njihet e që mund dhe duhet kërkuar e zbuluar dikur e diku në arkiva të ndryshëm brenda dhe jashtë hapësirës shqipfolëse. Mungesa e tij në doracakë të mirëfilltë enciklopedikë është padyshim një ndeshtrashë sa e hidhur aq edhe e lashtë e natyrës shqiptare që i ngushëllon dhe i mban bashkë gjithë ata breza personalitetesh të fshira (pa)vetëdijshëm prej kujtesës historike-intelektuale shqiptare.

SUMMARY

This study is dedicated to a not well-known personality in the history of Albanian culture, Monsignor Ndue Babi. He led the Diocese of Shkodra for 25 years, from 1703 to 1728. The study focuses mainly on his pastoral activity as a priest and later Bishop, on his active participation in the Assembly of Arbër (Crimea, 14-17 January 1703) as well as on his organizational skills during the Diocese Synod of Shkodra (Beltojë, 31 March 1704). The study concludes with a special section on Author's suggestion to place this personality among others in the Albanian culture and literature as an author of a lot of Albanian articles, among which "*Mallkimet qi leshon ipeshkëvi t'Ejten e Madhe*" (= *it.*) *The Scommunicati on Thursday Santo*.

Bibliografi

Burime

AQSH: Arkivi Qendror i Shtetit të Republikës së Shqipërisë (Tiranë)

ASPF: Archivio Storico de Propaganda Fide (Roma)

Bartl, Peter

1979: Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte im 17. und 18. Jahrhundert, Bd. II, në radhøjën „Albanische Forschungen“ Nr. 20, Wiesbaden.

Eubel, Conrad (~ Ritzler, Remigium et Sefrin, Pirminum)

1958 Hierarchia Catholica Medii et recentioris aevi, volumen VI, 1730-1799. Patavii.

Farlati, Daniele & Coleti, Jacopo

1817 Illyricum sacrum, t. VII. Venetiis.

Zmajević, Vincenz 1703: Relazione dello stato d'Albania e Servia visitate da Vincenzo Zmajevich Archivescouo d'Antivari. nell Anno MDCCII in III. (shih lart Bartl, Peter 1979 1 – 186)

Literaturë shkencore

Bartl, Peter & Demiraj, Bardhyl

2008: Letra e fretërve të Pultit (1761) dhe vendi i saj në kulturën e shkrimit shqip në mes të shek. 18-të, në: "*Hylli i Dritës*" 4 39 – 58.

Bartocetti, Vittorio

1935: Il Collegio illirico di San Pietro e Paolo di Fermo (1663 - 1746), në: "*Studia Picena*" 11 133-162

Demiraj, Bardhyl

2008: shih më lart Bartl, Peter 2008.

2012: Demiraj, Conci i Provincialis o Cuvendi j Arbenit (Roma 1706). Botim kritik, Botime françeskane, Shkodër 2012, 504 S.

2014: Mallkimet që lëshon ipeshkvi të Enjten e Madhe (1744 ?), në: „Hylli i Dritës” 3-4 140-163.

2015: Jetë rishtarësh shqiptarë në Kolegjin Ilirik të Feros (1663 - 1746), në: „Hylli i Dritës” 1-2 426-448.

FESH Fjalor Enciklopedik Shqiptar, (bot. II) Tiranë 2008/9.

Rrota, Justin

1941: 4. Pjetër Bogdani - Kryevepra (1685); në: “Shkrimtarët shqiptarë” Pjesa I. (1462-1878). Për klasën e tretë e të katërt të kursit të naltë. Tiranë 1941, f. 46-65.